

- Komisioneri paraqet raport vjetor përpara Kuvendit dhe raporton përpara tij sa herë i kërkohet. Gjithashtu, ai mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohe për çështje që i çmon të rëndësishme (Neni 31).

#### 2. Puna e Komisionerit, detyrat dhe përgjegjësitë

Puna e Komisionerit është që të sigurohet se nga Kontrolluesit dhe Përpunuesit po veprohet në përputhje me ligjin. Në ligjin organik të institucionit të Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale janë parashikuar saktësisht të gjitha të drejtat e përgjegjësitë e Komisionerit.

#### a. Sipas nenit 30 të ligjit Komisioneri ka këto të drejta:

- Kryen hetim administrative dhe **ka të drejtën e aksesit** në punënimet e të dhënave personale, si dhe ka të drejtë të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për përbushjen e detyrave të mbikëqyrjes.
- Urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale.
- Jep udhëzime përpara se përpunimet të kryhen dhe siguron publikimin e tyre.
- Komisioneri ka akses në sistemin e kompjuterave, në sistemet e arkivimit, që kryejnë përpunimin e të dhënave personale dhe në të gjithë dokumentacionin, që lidhet me përpunimin dhe transferimin e tyre, për ushtrimin e të drejtave dhe të detyrave që i janë ngarkuar me ligj (neni 32/2).
- Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më pare (neni 21).
- Komisioneri shqyrton të gjitha njoftimet dhe kur njoftimi është i pamjaftueshëm, ai urdhëron kontrolluesin të plotësojë të dhënat, duke përcaktuar edhe afatin kohor (neni 23).
- Komisioneri, në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, e konsideron shkeljen kundërvajtje administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave ( neni 39).

#### b. Sipas nenit 31 të ligjit Komisioneri është përgjegjës për:

- Dhënien e mendimeve për aktet ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale.
- Dhënien e autorizimit, në raste të veçanta, për përdorimin

e të dhënave personale për qëllime jo të përcaktuara në grumbullimin e tyre, duke respektuar parimet e nenit 5 të këtij ligji(për mbrojtjen e të dhënave personale).

- Dhënien e autorizimit për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji(transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale).
- Nxjerrjen e udhëzimeve, ku përcaktohet koha e mbajtje së të dhënave personale, sipas qëllimit të tyre, në veprimtarinë e sektorëve të veçantë;
- Sigurimin e së drejtës së infomimit dhe të ushtrimit të së drejtës së korrigjimit e të përditësimit të të dhënave.
- Dhënien e autorizimit për përdorimin e të dhënave sensitive, në përputhje me shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji(autorizim për një interes të rëndësishëm publik).
- Kontrollimin e përpunimit të të dhënave, në përputhje me ligjin, me kërkesë të një personi, kur një përpunim i tillë është i përjashtuar nga e drejta e informacionit dhe vënien në dijeni të personit se kontrolli është kryer, si dhe verifikimin nëse procesi është i ligjshëm ose jo.
- Zgjidhjen e ankimeve të çdo personi, për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tij, për përpunimin e të dhënave personale dhe vënien e tij në dijeni për ecurinë.
- Nxjerrjen e udhëzimeve për marrjen e masave të sigurisë në veprimtarinë e sektorëve të veçantë.
- Kontrollin e zbatimit të gjobave.
- Përgatitjen, në bashkëpunim, të kodeve të etikës (Kodet e etikës janë sjellja e punonjësve të organeve publike e private në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Publikimin dhe shpjegimin e të drejtave për mbrojtjen e të dhënave dhe publikimin periodikisht të veprimtarive të zhvilluara prej tij.
- Bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse për të dhënat personale të shteteve të huaja, për mbrojtjen e të drejtave të individëve rezidentë në këto shtete.
- Përfaqësimin e autoritetit mbikëqyrës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Kontrolluesi është përgjegjës për zbatimin e kërkesave lidhur me mbrojtjen e të dhënave në të gjitha përpunimet automatike ose me mjete të tjera të të dhënave(neni 5/2).
- Në rast se aksesit mohohet, duke argumentuar se cenohen interesat e sigurisë kombëtare, politika e jashtme, interesat ekonomike dhe financiare të shtetit, parandalimi dhe ndjekja e veprave penale ose liria e shprehjes dhe infomimit apo liria e shtypit, subjekti i të dhënave mund t'i kërkojë komisionerit të kontrollojë përjashtimin në rastin konkret. Komisioneri informon subjektin e të dhënave për masat e marra(neni 12/5).
- Komisioneri shqyrton të gjitha njoftimet dhe kur njoftimi është i pamjaftueshëm, ai urdhëron kontrolluesin të plotësojë të dhënat, duke përcaktuar edhe afatin kohor (neni 23).

- Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave personale. Rregulla të hollësishme për sigurimin e të dhënave përcaktohen me vendim të komisionerit.
- Procedurat e administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre përcaktohen me vendim të komisionerit.
- Ushtrimin e detyrave të tjera ligjore.
- Komisioneri krijon një regjistër për dokumentimin e të gjitha njoftimeve dhe autorizimeve, që ai kryen në ushtrim të kompetencave të tij, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale(neni 31).

#### c. Sanksionet administrative të Komisionerit.

Për të garantuar zbatimin me efikasitet të kërkesave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* janë parashikuar dhe sanksionet administrative, **(gjobat nga 10.000 në 50.000 lekë)** që merren nga Komisioneri për rastet e shkeljes së të drejtave të subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit. **Ndërsa në nenin 41** të ligjit është parashikuar dhe mënyra e ekzekutimit të gjobës së vënë me vendim të Komisionerit.

1. Gjobat paguhen nga kundërvajtësi jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i tyre.

Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit, me kërkesë të komisionerit.
2. Gjobat arkëtohen në Buxhetin e Shtetit.

#### 3. Zyra e Komisionerit

Në nenin 37 ligji parashikon funksionimin e Institucionit nëpërmjet **Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**. Sipas këtij ligji dhe akteve të Kuvendit të Shqipërisë:

- Punonjësit e zyrës së Komisionerit, përbëjnë stafin administrativ të organizimit dhe funksionimit të këtij institucioni.
- Kuvendi vendos për pagën e Komisionerit, strukturën organizative dhe klasifikimin e pagave për punonjësit e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Punonjësit e kësaj zyre gëzojnë statusin e nëpunësit civil, dhe trajtohen sipas dispozitave të veçanta për Institucionet e pavarura, të parashikuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 **“Statusi i Nëpunësit Civil”** dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Struktura e Zyrës së Komisioneres është vendosur me Vendimin e Kuvendit nr.225, datë 13.11.2008.

#### Si mund të ankoheni tek zyra e Komisionerit ?

Nëse viheni në dijeni se të dhënat tuaja po përpunohen në kundërshtim me rregullat që përmendëm më sipër që parashikohen në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, nëse gjendja nuk rregullohet pas njoftimit të Kontrolluesit, ju mund ti drejtoheni zyrës së Komisionerit, e cila do të ju ndihmojë për të vënë situatën në vend dhe do të parandalojë futjet e paautorizuara në të drejtën e privatësisë tuaj.


Për tju drejtuar zyrës së Komisionerit mund të plotësoni Formularin e ankesës bashkëngjitur:

#### Si Konkluzion

Miratimi i ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ngritja e zyrës së Komisionerit janë ngjarje të rëndësishme, që do të japin kontribut thelbësor në përbushjen e qëllimeve, objektivave dhe strategjive të vendit tonë në respektim të të drejtave të njeriut, në përputhje me standartet e Bashkimit Evropian.

Literatura teknologjike tregon se zhvillimet e sotme në inteligjencën artificiale, shpejtësia e përpunimeve kompjuterike dhe kapacitetet tejet të mëdha të ruajtjes së informacioneve, përgëndrimit të jashtzakonshëm të të dhënave personale, lidhjes së tyre të drejtëpërdrejtë dhe kontrollit të tyre të përsheptuar, ka njohur një shpalosje shumë më të madhe nga sa mund të hamendësohet prej shumë qytetarëve, duke arritur në disa raste në profilizimin e tyre.

Pikërisht në përputhje me këto zhvillime dhe mbështetur në direktivën e Bashkimit Evropian dhe asistencën e ekspertizës ligjore të KE, me hartimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale edhe në Shqipëri, si dhe zgjedhjes së Komisionerit dhe vënies në funksionim të zyrës së tij, u prodhuan bazat për mbrojtjen e të dhënave personale nga institucionet publike e private.



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**


**INFORMATION AND DATA PROTECTION COMMISSIONER**

#### KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE

#### MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Njihuni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe me Zyrën e

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale!



#### Çdo shtetasi në Republikën e Shqipërisë i garantohen këto të drejta:

Sipas Kushtetutës

- Askush nuk mund të detyrohet, përveç kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij.*
- Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj.*
- Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.*
- Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.*

Sipas ligjit të ri nr. 9887, datë 10.3.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*

- Të kërkojë nga organet shtetërore dhe private konfirmimin nëse të dhënat e tij po përpunohën ose jo (e drejta për akses).**
- Të kërkojë korrigjim ose fshirje të të dhënave, kur janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me ligjin.**

- Të kundërshtojë, në çdo kohë përpunimin e të dhënave rreth tij.**

- Individët kanë të drejtë të mos jenë subjekt të vendimmarrjes automatike.**

- Të ankohet ose të njoftojë Komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të të drejtës së shkelur.**

- Të kërkojë kompensimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale.**

#### Cilat janë të dhënat personale?

Ligji në nenin 3 të tij përcakton kuptimin e të dhënave personale dhe të dhënave sensitive të një personi fizik dhe konkretisht :

a) *“E dhënë personale”* është çdo informacion për një person fizik, i cili është i identifikuar ose i identifikueshëm. Elementet, me të cilat realizohet identifikimi i një personi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, janë numrat e identitetit ose faktorë të tjerë të veçantë fizikë, psikologjikë, ekonomikë, socialë, kulturorë etj.

## FORMULARI I ANKESËS



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

<b>Ankesë</b>	
Ankuesi: Emri _____	Drejtuar: Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Mbiemri _____	
Adresa: _____	Rr. e Kavajës, Nd 80, H.1, Tiranë
_____	

### Përmbajtja e ankesës:

- Institucioni publik, privat ose personi fizik për të cilin ankoheni,

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

- Veprimi ose mosveprimi i organit që e konsideroni shkelje,

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



*Të tillë elementë mund të jenë : Emri,mbiemri, atësia, mëmësia, datëlindja, vendlindja, vend banimi, arsimi, profesioni, kombësia, shtetësia, gjendja civile, i martuar, fëmijët, seksi, ngjyra e syve, flokëve, gjatësia, fotografia, gjurmët e gishtave, gjuhët e huaja, etj. Shembuj të tjerë përfshijnë : informacione për klientët individual, të dhëna personale të punonjësve, referenca për individët në dokumente, përfshirë mesazhe me email, fotografitë e individëve, regjistrime të telefonave që janë bërë nga dikush ose në drejtim të dikujt, faturat që individët kanë për gazin apo energjinë elektrike, telefonat, informacione për llogaritë bankare të personave apo për policat e tyre të sigurimit, të dhënat e regjistrimit në një hotel, databazat qeveritare për taksapaguesit, mbajtësit e lejeve për drejtimin e automjeteve, pronarët e automjeteve, marrësit e përfitimëve etj.*

b) *"E dhënë sensitive"* është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

*Të dhëna sensitive mund të jenë dhe tiparet biologjike unike, të dhënat biometrike, gjurmët e gishtrinjëve, imazhe të retinës, karakteristikat gjenetike, etj.*

Kontrolluesit gjatë marrjes në punë përpunojnë të dhëna si emri, mbiemri, gjendja civile, arsimi etj, që janë të dhëna personale të zakonshme, por ndërmjet tyre marrim dhe të dhëna si gjendja shëndetësore (raporti mjeksor), dëshminë e penalitetit etj, që janë të dhëna sensitive.

**Kush ka të drejtë të marrë të dhëna personale?**

Në ligj përcaktohen qartë dhe gjërësisht **marrësit e përpunuesit e të dhënave personale**.

Në nenin 3/8 të ligjit përcaktohet:“*Marrës*” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilëve u jepen të dhëna personale.

Si marrës kryesor të të dhënave personale, që më poshtë do të quhen Kontrollues e Përpunues, konkretisht mund të jenë:

**Kontrollues të vendosur në R.Shqipërisë**

- Drejtoria Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe zyrat e veçanta të saj.
- Drejtoria e Arkivave të Shtetit.
- Institucionet e Sigurimeve Shoqërore (numri i sig).
- Organet Tatimore dhe Doganore.
- Drejtoritë e Postave.
- Telekomunikacioni.
- Spitaleat.
- Ministritë.
- Mediat vizive dhe auditive.
- Inspektoriat i Deklarimit të Pasurive.
- Institucionet e lëshimit të licensave.
- Qendra Kombëtare e Regjistrimit
- Organizata jofitimprurëse (Fondacione, Shoqata) e Partitë.

- Ambasadat e Konsullatat.
- Kompanitë e Sigurimeve
- Drejtoria dëshmive të aftësive të automjeteve.
- Zyrat e Regjistrimit të Pasurive.
- Bankat ( për pagat, depozitat etj).

*Këto organe e marrin informacionin shpesh nga vetë njerëzit. Për shembull, kur shkoni në bankë për të hapur një llogari, kur shkoni në një kompani sigurimesh apo tek mjeku, ju kërkojnë informacion mbi veten. Mënyrat e tjera që janë më pak të dukshme. Për shembull, sa herë që përdorni celularin, vizitoni një faqe internet apo përdorni kartën e kreditit, juve i jepni informacion ofertuesit të shërbimit.*

**Kontrollues që janë vendosur jashtë vendit:**

- Misionet diplomatike ose zyrat konsullore të shtetit shqiptar.
- Kontrollues, të cilët nuk janë të vendosur në Republikën e Shqipërisë, por që e ushtrojnë veprimtarinë nëpërmjet përdorimit të çdo mjeti, që ndodhet në R.Shqipërisë. *Pra* Kontrolluesve, të gjithë institucioneve publike e private u nevojitet informacion për njerëzit në mënyrë që të japin shërbimet që njerzit kërkojnë. *Organet shtétrore qëndrore e vendore, shoqatat, fondacionet qendrat shëndetësore, shkollat, bankat, kompanitë e sigurimit, kompanitë e telefonisë celulare, ofertuesit e shërbimit të internetit, agjensitë e udhëtimit, dyqanet e shumtë të tjerë mbledhin informacion personal. Informacioni është i nevojshëm për drejtimin e një shoqërie moderne.*

*Pjesa më e madhe e institucioneve e organizatave e përdorin informacionin në mënyrë të përgjegjshme, por, gjërat mund të mos shkojnë mbarë. Për shembull, nese informacioni juaj është i pasaktë, mund të mos e fitoni punën që dëshironi apo t’ju mohohet një përtitim nga shteti në rastin kur ju takon. Informacioni juaj mund të humbas apo të vhidet, gjë që do të thotë se njerëz të paaautorizuar mund ta shtien atë në dorë dhe ta përdorin për qëllime të dëmshme. Pikërisht për këto tani ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, ju ndihmon që të mbronj informacionin tuaj. Punonjësit si individë nuk janë kontrollues në të drejtën e tyre vetjake. Megjithatë ata duhet të veprojnë në përputhje me udhëzimet për kontrolluesit. Individët që punojnë të dhëna personale për llogari të tyre janë gjithashtu kontrollues.*

**Rregullat se si duhet të merren dhe përpunohen të dhënat personale.**

Në nenet 5-11 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale përcaktohen saktë rregullat që detyrohen të zbatojnë Organet shtetërore dhe ato private për rastet e përpunimit të të dhënave personale të individëve.

**Kështu në nenin 4** të tij ligji shtjellon kushtet ligjore të përpunimit të të dhënave :

- Përpunimi të bëhet në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme.



- Grumbullimi të bëhet për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përputhje me këto qëllime.
- Të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.
- Në saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, përditësimin e kryerjen e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen.
- Në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

**Ndërsa në nenin 6** ligji shtjellon Kriteret ligjore të përpunimit. Të dhënat personale përpunohen vetëm :

- Nese subjekti i të dhënave personale **ka dhënë pëlqimin;**
- Për hartimin dhe përmbushjen e kontratave, në të cilat subjekti i të dhënave personale është palë.
- Për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave.
- Për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit.
- Për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetenca të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat.
- Për ndjekjen e interesave legjitime të kontrolluesit ose të një pale të tretë, të cilës i janë përhapur të dhënat, përveç kur këta interesa mbizotërojnë mbi interesat për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të subjektit të të dhënave.

**Në nenin 7 të ligjit** përcaktohen kushtet dhe kriteret për përpunimin e të dhënave **sensitive**: Ato mund të merren dhe përpunohen vetëm kur :

- Subjekti i të dhënave **ka dhënë pëlqimin, që mund të revokohet në çdo çast** dhe e bën të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave.
- Është në interes jetik të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër dhe subjekti i të dhënave është fizikisht ose mendërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e vet.
- Autorizohet nga autoriteti përgjegjës për një interes të rëndësishëm publik (Komisioneri, Bashkia etj.) etj.

**Ligji thekson: Ndalohet përpunimi i** të dhënave, që zbulojnë origjinën racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësinë në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimet penale, si dhe shëndetin e jetën seksuale.

**Për shkak të veçantisë** dhe rëndësisë së të dhënave sensitive, përpunimi i tyre në rrethana të tjera nga ato të përcaktuara sipër kërkohet **të rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave**, por vetëm për qëllime të interesave të rëndësishme publike, nën masa të përshtatshme mbrojtëse (neni 7).

**Ligji parashikon Rregulla dhe për transferimin e të dhënave personale.**

**Në ligj shtjellohen hollësisht** rregullat për dërgimin (transferimin) e të dhënave jashtë vendit.

Dërgimi i të dhënave personale në një vend tjetër është i njohur si transferim ndërkombëtar. Te dhënat personale mund të dërgohen vetëm në vende që sigurojnë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave, përveç rasteve kur gjen zbatim përjashtimi.

Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, **përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave**.

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, në raste të tjera nga ato të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, **bëhet me autorizim të Komisionerit**.

**Në ligj përveç rregullave** për përpunimin e të dhënave personale të individëve nenet 18 deri 20 parashikohen dhe detyrimet e subjekteve përgjegjës të ligjit, Kontrolluesit e Përpunuesit.

**Detyrimet e Kontrolluesit**
**a. Detyrimi për të zbatuar kërkesat e sipërme të ligjit lidhur me përpunimin e të dhënave.**

**b. Detyrimi për informuar subjektin për përpunimin e të dhënave**.(neni 18).

**c. Detyrimi për korrigjim ose fshirje të të dhënave të pasakta**.(neni 19).

**ç. Përgjegjësia për të njoftuar Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale të shtetasve**.(neni 21)

Ligji përcakton dhe përjashtimet nga rregulli i njoftimit :

- Përgjashtohet** nga detyrimi për të njoftuar përpunimi i të dhënave personale, me qëllim mbajtjen e një regjistri, i cili, në përputhje me ligjin ose aktet nënligjore, siguron informacion për publikun në përgjithësi.
- Përgjashtohen** nga detyrimi për të njoftuar të dhënat personale që përpunohen, me qëllim mbrojtjen e

institucioneve kushtetuese, të interesave të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, interesave ekonomike ose financiare të shtetit, apo për parandalimin e ndjekjen e veprave penale.

Rastet e tjera, për të cilat njoftimi nuk është i nevojshëm, përcaktohen me VKMinistrave.

**d. Detyrimi për të vepruar me autorizim të Komisionerit** (neni 24) .

- Për përpunimin e të dhënave sensitive.
- Për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

**e. Detyrimi për të filluar përpunimin pas njoftimit te Komisioneri për përpunimin e të dhënave**.(neni 25).

**ë. Detyrimi e përgjegjësia për sigurinë e të dhënave personale**.(neni 27).

Është e rëndësishme që të dhënat personale të mbahen të sigurta dhe që të mos keqpërdoren apo korruptohen në ndonjë mënyrë.

Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm në natyrën e përpunimit të të dhënave personale. **Rregulla të hollësishme** për sigurinë e të dhënave përcaktohen **me vendim të Komisionerit**.



**e. Detyrimi e përgjegjësia për Konfidencialitetin për të dhënat personale** (neni 28).

**f. Detyrimi të zbatojë të gjithë të drejtat e subjektit të të dhënave të parashikuara në ligj**.(nenet 12-17).

**g. Detyrimi për të zbatuar të gjitha detyrat e përgjegjësitë e Komisionerit të parashikuara në këtë ligj**.(nenet 29-31).

**gj. Detyrimi i të gjithë institucioneve publike dhe private të bashkëpunojnë me Komisionerin, duke i siguruar të**

**gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave**.(neni 32).

**Detyrimet e Përpunuesit** (neni20)

Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues dhe në kontratën e lidhur kërkohet garantimi për përdorimin e ligjshëm dhe të sigur të të dhënave.

**Kush i mbron të dhënat personale të shtetasve nga marrja e përpunimi i paligjshëm i tyre?**

Një nga gjërat kryesore më të rëndësishme të ligjit është krijimi i një autoriteti mbikëqyrës të pavarur, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, puna e të cilit është që të sigurohet që nga Kontrolluesit dhe Përpunuesit e të dhënave personale të shtetasve po veprohet në përputhje me ligjin.

**1. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si autoritet mbikëqyrës i pavarur**

**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale** është autoritet mbikëqyrës i pavarur, kjo përmendet qartë në nenet 29-38 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konkretisht po përmendim:

- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti përgjegjës, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (neni 29).
- Komisioneri zgjidhet nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje (neni 33,35,36).
- Informacioni i siguruar nga Komisioneri, gjatë ushtrimit të detyrës, përdoret vetëm për qëllime mbikëqyrjeje, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Komisioneri është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të dhënave edhe pas mbarimit të detyrës (neni 29).
- Funksioni i komisionerit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër shtetëror, me anëtarësimin në partitë politike dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë e tyre, si dhe me çdo veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies (neni 34).
- Komisioneri është person juridik publik dhe ka buxhetin e vet të pavarur, i cili finanohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga donacione të ndryshme (neni 38).
- Kuvendi vendos për pagën e komisionerit, strukturën organizative dhe klasifikimin e pagave për punonjësit e zyrës së komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale (neni 37).
- Institucionet publike dhe private detyrohen të bashkëpunojnë me komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave (neni 32).

<p><b>c.</b> Ndhima ligjore që kërkon nga Zyra e Komisionerit,</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>_____</p>	
<p><b>d.</b> Dokumentet provuese të bashkangjitura,</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>_____</p>	
Ankuesi _____	Data _____
_____	

<b>Ju mund të kontaktoni me: Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale</b>
<span></span>
Në adresën: Rr. e Kavajës, Nd 80, H.1, Tiranë
Tel: +355 4 2237200; Fax: +355 4 2233977
e-mail: info@idp.al, Website: www.idp.al